



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR MINISTRINË E MBROJTJES
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, Maj 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Mbrojtjes, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Lavdim Maxhuni udhëheqës i ekipit dhe Florë Berisha-Kutllovci anëtare e ekipit, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Bujar Bajraktari.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Qeverisja e mirë.....	17
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	19
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	22
Shtojca II: Letër konfirmimi.....	24

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 26.11.2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Mbrojtjes.

Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm


Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Menaxhmenti është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase.
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë së Mbrojtjes (MM), nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste substanciale si dhe aranzhimet e qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund ti gjenden në Shtojcën II.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar dhe se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Mbrojtjes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme, të modifikuar, si dhe është përgjegjës për zbatimin e kontroleve të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Ministria kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 për shpenzimin e parave publike dhe Rregullën Financiare nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve, dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Ministria e Mbrojtjes ka diskutuar me Thesarin, dhe i ka korigjuar PFV-të me datën 13.02.2019.

Në kontekst të PFV-ve nuk kemi asnjë çështje për të ngritur.

Prandaj, deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë dhe e drejtë.

As në lidhje me kërkesat tjera për raportim nuk kemi çështje për të ngritur.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

MM në përgjithësi ka vendosur kontrole të mira në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Megjithatë auditimi ka identifikuar disa fusha ku ka nevojë për veprime korigjuese. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë hartimi i specifikave teknike të tenderëve, duke marrë për bazë hulumtimin e tregut, raportimi i menaxherëve të projekteve sipas kërkesave që dalin nga vendimet për caktimin e tyre, respektimi i afateve ligjore për inventarizimin e pasurive, dhe komiteti i auditimit t'i përmbushë obligimet ligjore.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	53,667,393	49,496,883	47,061,129	34,621,895	43,872,641
Granti i Qeverisë -Buxheti	53,667,393	49,496,883	47,061,129	34,621,681	43,862,855
Donacionet e brendshme	0	0	0	0	9,786
Donacionet e jashtme	0	0	0	214	0

Buxheti Final në raport me Buxhetin Fillestar ishte zvogëluar për 4,170,510€. Ky zvogëlim është si pasojë e shkurtimeve buxhetore që janë bërë me Vendime të Qeverisë.

Në vitin 2018, Ministria ka shpenzuar 95% të buxhetit final. Përqindje e përafërt ishte edhe vitin e kaluar (96%). Nga kjo mund të konkludojmë se Ministria në përgjithësi buxhetin e kishte shpenzuar brenda limiteve të përcaktuara nga Kuvendi.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	53,667,393	49,496,883	47,061,129	34,621,895	43,872,641
Pagat dhe Mëditjet	22,195,048	21,670,478	21,669,738	20,886,612	21,071,464
Mallrat dhe Shërbimet	11,792,345	11,692,345	10,061,933	8,941,674	8,190,467
Shërbimet komunale	950,000	684,864	671,355	814,849	802,212
Investimet Kapitale	18,730,000	15,449,196	14,658,103	3,978,760	13,808,498

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikimet që kanë pasur në aktivitetet e përgjithshme vjetore të ministrisë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte zvogëluar për 524,570€ me vendim të Qeverisë , në emër të kursimeve buxhetore. Buxheti final ishte realizuar pothuajse 100%.
- Te mallrat dhe shërbimet, buxheti final në raport me atë fillestar ishte zvogëluar për 100,000€. Kjo kishte ndodhur me vendim të Qeverisë, në emër të kursimeve buxhetore. Nga buxheti final ishin shpenzuar 10,061,933€ apo rreth 87% e buxhetit.
- Edhe tek shërbimet komunale buxheti final ishte zvogëluar për 265,136€ në emër të kursimeve buxhetore, me vendim të Qeverisë, ndërsa ishin shpenzuar 671,355€ apo 98% e buxhetit final.
- Buxheti final për investime kapitale në raport me atë fillestar ishte zvogëluar për 3,280,804€. Për shkak se disa projekte të planifikuara nuk ishin realizuar, këto mjete ishin deklaruar si kursime buxhetore. Edhe ky zvogëlim ishte bërë me vendime të Qeverisë. Shpenzimi në këtë kategori ishte 14,658,103€ apo rreth 95% e buxhetit final. Kjo paraqet një performancë të mirë në krahasim me vitet paraprake.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.1 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar që menaxhohet nga MF. Megjithatë janë një sërë kontrollesh të cilat operojnë në kuadër të MM-së, e të cilat ndërlidhen me përcaktimin e koeficientëve të pagave, avancimin dhe aprovimin e shtesave etj. Prandaj është e rëndësishme që të ketë kontrolle efektive për të siguruar se këto veprime janë në përputhje me rregullat e përgjithshme. Në këtë kategori nga 21,670,478€ sa ishte buxheti final, ishin shpenzuar 21,669,738€ apo shprehur në përqindje pothuajse 100%.

Për qëllime ekzaminimi, ne kemi përzgjedhur 40 mostra për testim substancial dhe 28 mostra për testim të pajtueshmërisë. Testimet tona kanë rezultuar me gjetjen në vazhdim:

Rekomandimi

Çështja A1 – Mos azhurnimi i dosjeve të personelit

Gjetja Vendimi i Qeverisë 06/29 të datë 15.05.2015 mbi dëshminë e përvojës së punës përcakton se vendimi i përvojës së punës bëhet pjesë e dosjes së personelit për secilin nëpunës dhe ruhet sipas legjislacionit në fuqi.

Ne kemi gjetur se në 15 nga 40 mostrat e testuara në dosjet e personelit mungonte vendimi për njohjen e përvojës së punës.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së rishikimit formal i dosjeve të personelit nga ana zyrtarëve përgjegjës.

Rreziku Mos azhurnimi i dosjeve të personelit me kohë rritë rrezikun që stafi i ministrisë të mos paguhet për pjesën e pagës si rezultat i përvojës në punë.

Rekomandimi A1 Ministri duhet të siguroj se kontrollet e brendshme në fushën e menaxhimit të personelit do të forcohen, me qëllim që dosjet të azhurnohen me kohë dhe të përmbajnë informatat komplete për të gjithë të punësuarit e institucionit.

3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë edhe shërbimet komunale) në vitin 2018 ishte 12,377,209€. Prej tyre ishin shpenzuar 10,733,288€. Ato kanë të bëjnë me furnizime me pjesë rezervë për automjetet e FSK, furnizim me ushqim, furnizim me veshje sportive për nevojat e FSK-së, furnizim me pajisje të teknologjisë informative, furnizim me uniforma, furnizim për zyre etj. Për testim substancial kemi përzgjedhur 22 mostra me vlerë 1,853,845€, dhe për qëllime të pajtueshmërisë shtatë (7) kontrata me vlerë 1,689,497€. Testimet tona kanë rezultuar me çështjet në vijim.

Rekomandimet

Çështja A2 - Mos konfiskimi i sigurimit të ekzekutimit

E gjetura Sipas Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktues (AK) do të konfiskoj sigurimin e ekzekutimit në situatat e mëposhtme: Në rast të shkeljes së kontratës së nënshkruar, e cila shkakton dëme materiale për AK, dhe/ose kërkon që AK të shkaktoj shpenzime të konsiderueshme në përfundimin e kontratës së tillë.

Ne kemi vërejtur se te kontrata - Furnizim me pajisje fushore (karrika dhe tavolina) për nevojat e FSK-së, me vlerë 29,500€, OE fitues nuk ju kishte përmbajtur kushteve të kontratës, pasi që furnizimet nuk ishin konform specifikacioneve teknike të kontraktuara. Menaxheri i kontratës e kishte refuzuar pranimin e këtyre paisjeve, duke kërkuar që të sillen pajisje tjera konform specifikave të kërkuara, mirëpo OE ka dështuar t'i liferojë pajisjet sipas specifikave të kontraktuara. Përkundër mos përmbushjes së kësaj kontrate, ministria nuk ka ndërmarrë masat për konfiskimin e sigurisë së ekzekutimit, siç ishte paraparë në kontratë. Për shkak të mos furnizimit me këto pajisje janë shkaktuar vështirësi në realizimin e trajnimeve/ushtimeve fushore të planifikuara të FSK-së

Kjo ka ndodhur për shkak të moskujdesit të stafit të ministrisë në lidhje me përcjelljen e afatit të vlefshmërisë së sigurisë së ekzekutimit.

Rreziku Mos konfiksimi i sigurimit të ekzekutimit nga ana e ministrisë, rritë rrezikun që OE-të të mos i përmbushin obligimet e tyre nga kontratat, dhe objektivat e ministrisë të mos arrihen.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të siguroj se Departamentet përkatëse për zbatimin e kontratave, të zbatojnë të gjitha dispozitat lidhur me obligimet e palëve në marrëveshje dhe pa vonesë të ekzekutojnë të gjitha garancionet për sigurinë e ekzekutimit nga ana e OE, duke mos përjashtuar edhe paditë gjyqësore.

Çështja A3 – Vonesa në liferimin e mallrave

Gjetja Bazuar në kushtet e veçanta të kontratës kornizë “Furnizim me pajisje individuale” neni 2 thekson se afati i liferimit duhet të jetë jo më shumë se 90 ditë nga momenti i pranimit të urdhërbljes, përveç për tre artikujve, sepse këta artikuj i nënshtrohen regjimit të lejeve të importit dhe për ta nuk aplikohen penalltitë në raste të vonesave.

Ne kemi identifikuar se në dy (2) nga 22 mostra që kishim për testim, OE kishte pasur vonesa në liferimin e mallrave (nga 7 ditë deri në 40 ditë), ndërsa ministria nuk kishte aplikuar gjoba ndëshkuese. Në rastin e parë ndëshkimet nuk janë zbatuar fare dhe vlera e tyre që duhej të llogaritet ishte 2,247€, ndërsa tek rasti i dytë, ato janë zbatuar pjesërisht, dhe shuma e pa kalkualuar e tyre ishte 313€. Kjo kishte ndodhur për shkak të pakujdesisë së zyrtarëve në zbatimin e ndëshkimeve të parapara në kontrata.

Rreziku Mos aplikimi i gjobave ndëshkuese me rastin e vonesave në liferimin e mallrave, rrit rrezikun që OE të mos i zbatojnë kushtet e kontratave dhe furnizimin e mallrave/pajisjeve ta bëjnë me vonesë, me ndikimin që aktivitetet e ministrisë të realizohen me vonesë apo të mos realizohen sipas planeve të përcaktuara.

Rekomandimi A3 Ministri duhet të siguroj se do të zbatohen kontrole më rigoroze në monitorimin e zbatimit të kontratave, dhe në rast të vonesave në liferimin e mallrave, të aplikohen ndëshkimet e përcaktuara sipas kushteve të parapara me kontratë.

3.1.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 15,449,196€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 14,658,103€, apo shprehur në përqindje rreth 95%. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin dhe rregullimin e objekteve për Forcën e Sigurisë së Kosovës, blerjen e automjeteve taktike, blerjen e kamionëve të ndryshëm, si dhe blerjen e pajisjeve tjera. Në këtë kategori të shpenzimeve për qëllime të testeve substanciale kemi ekzaminuar 24 pagesa me vlerë 9,271,031€, dhe shtatë (7) kontrata me vlerë 2,975,428€ për qëllime të pajtueshmërisë.

Çështja A4 - Hartimi i dobët i specifikave teknike të projekteve kapitale

Gjetja Sipas Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ të prokurimit publik neni 20 paragrafi 20.4 Specifikimet /Termet e referencës duhet të jenë të qarta, të sakta dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të panevojshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Ato duhet të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë dyshime rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara.

Ndërsa njësitë kërkuese në kuadër të MM-së, dhe FSK-së nuk kanë arritur të bëjnë analiza të mjaftueshme gjatë hartimit të kërkesave teknike (specifikacionit teknik) duke e përfshirë edhe hulumtimin e tregut në planifikimet e projekteve të përcaktuara. Si rrjedhojë e kësaj, departamenti i prokurimit gjatë analizës së kërkesave i ka kthyer prapa së paku pesë (5) kërkesa për shkak të specifikacioneve teknike (kur specifikacioni teknik ka qenë kufizues apo nuk ka përmbajtur të gjitha standardet e nevojshme të qëllimit të kontratës). Po ashtu, tetë (8) kërkesa janë kthyer për shkak të planifikimit të dobët buxhetor (mungesa e hulumtimit të tregut për projekte të caktuara), dhe si rezultat i kësaj ministria ka pasur vështirësi në realizimin e planit të prokurimit konform afateve të parapara.

Shkaku i ndodhjes së kësaj është se ka munguar një analizë e mirëfilltë nga njësitë kërkuese, dhe mungesa e kontrollit të brendshëm nga ana e akterëve përgjegjës për t'i eliminuar këto dobësi.

Rreziku Hartimi i dobët i specifikacioneve teknike nga ana e njërive kërkuese rrit rrezikun për paramasa dhe parallogari të gabuara të projekteve. Po ashtu, mungesa e një hulumtimi paraprak të tregut nga njësitë kërkuese, mund të rezultoj me anulim të procedurave të prokurimit dhe në mosrealizimin e planit vjetor të prokurimeve.

Rekomandimi A4 Ministri duhet të siguroj se me rastin e hartimit të specifikave teknike për projekte dhe furnizime, departamentet përkatëse paraprakisht bëjnë të gjitha analizat e duhura, përfshirë edhe ato të tregut, në mënyrë që projektet të realizohen brenda afateve optimale dhe me cilësinë e duhur.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurive jo financiare kapitale (mbi 1,000€) e paraqitur në PFV ishte 148,316,766€, ndërsa vlera e pasurive jo kapitale (me vlera nën 1000€) ishte 2,333,110€. Vlera e stokeve e shpalosur në PFV ishte 2,740,719€. Në bazë të planit të auditimit ne kemi shqyrtuar procedurat e zbatuara për menaxhimin e pasurive, përfshirë regjistrimin e pasurive, mirëmbajtjen e regjistrave dhe inventarizimin e pasurive në fundvit. Po ashtu, kemi ekzaminuar 30 mostra në këtë kategori, ku janë aplikuar teste substanciale dhe të pajtueshmërisë, si dhe kemi bërë ekzaminimin fizik të disa objekteve dhe makinerive. Përmes këtyre testeve, kemi vlerësuar se ministria ka bërë një

menaxhim të mirë të pasurive dhe regjistrave. Megjithatë mbetet të adresohet çështja e evidentuar më poshtë.

Rekomandimi

Çështja A5 – Vonesa në kryerjen e inventarizimit

Gjetja Sipas rregullës financiare nr. 02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jo financiare, inventarizimi bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare. Po ashtu, sipas udhëzuesit të brendshëm për menaxhimin e pasurive jo financiare kërkohet që komisioni i inventarizimit më së largu me datën 25 dhjetor (në rastin aktual me 25.12.2018) ta dërgoj raportin e përgjithshëm të inventarizimit tek Sekretari i Përgjithshëm.

Ne kemi identifikuar se komisioni i inventarizimit e kishte dorëzuar raportin për inventarizimin e pasurisë me datën 19.02.2019, pra me vonesë prej rreth dy (2) muaj në krahasim me kërkesat e udhëzuesit. Kjo nënkupton se nuk është bërë harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistrat e pasurive para se të përgatiten PFV-të.

Shkaku për këtë është se MM ka edhe shtatë (7) kazerma në qytete tjera dhe nën komisionet e formuara për kryerjen e këtij procesi janë vonuar derisa kanë konsoliduar raportet e tyre individuale dhe kjo ka ndikuar që pastaj të ketë vonesa në tërë procesin e inventarizimit.

Rreziku Mos kryerja me kohë e inventarizimit të pasurive pamundëson harmonizimin e regjistrave të pasurisë me raportin e inventarizimit, dhe rrjedhimisht, edhe konstatimin e diferencave lidhur gjendjen sipas regjistrimeve dhe gjendjen aktuale të pasurive. Në mungesë të barazimit të gjendjes, informatat për pasuritë e prezantuara në PFV mund të mos jenë të sakta dhe të plota.

Rekomandimi A5 Ministri duhet të siguroj që procesi i inventarizimit të kryhet në pajtim me kërkesat që dalin nga udhëzuesi i brendshëm për menaxhimin e pasurive, dhe të bëhet harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistrat e pasurive të organizatës, para përgatitjes së pasqyrave financiare.

3.3 Obligimet e papaguara

MM, ka shpalosur obligimet e papaguara në PVF-të për vitin 2018 në përputhje me Rregullën Financiare nr. 02/2013 për Raportimin e obligimeve të papaguara të OB-ve. Vlera e obligimeve ishte 169,304€. Mallra dhe Shërbime janë 105,708€, ndërsa Komunalit janë 63,596€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Shkaku për mbetjen e këtyre obligimeve është se pjesa më e madhe e faturave kanë ardhur në muajin dhjetor të vitit 2018.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasurit publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjerë janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Aranzhimet e qeverisjes në lidhje me raportimin menaxherial dhe llogaridhënien, si dhe menaxhimin e rrezikut pasqyrojnë një situatë pozitive. MM ka zbatuar pjesën më të madhe të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP), si dhe ka përgatitur raportin e menaxhimit të rrezikut, duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj, si dhe në baza tremujore e kishte monitoruar listën e rreziqeve.

Gjithashtu, MM kishte përgatit planin vjetor të organizatës në përputhje me atë strategjik dhe planin për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të arritjes së objektivave.

Duhet të theksojmë që Njësia e Auditimit të Brendshëm në vazhdimësi ka treguar një cilësi të lartë të punës, përmes së cilës ka dhënë vlerësime lidhur me funksionimin e kontrolleve në organizatë. Në këtë aspekt, përfitimi nga puna e auditimit të brendshëm duhet të merret në konsideratë nga menaxhmenti për përmirësimin e fushave me mangësi.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre anëtarë: drejtori i NjAB dhe dy auditorë. NjAB kishte përgatitur planin vjetor dhe strategjik bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe prioritetëve. Për vitin 2018, ishin planifikuar tetë (8) auditime të rregullta (pesë me rrezik të lartë, dhe tri me rrezik të mesëm). Ky plan ishte realizuar plotësisht, ndërsa auditimet kanë mbuluar

kryesisht procedurat dhe aktivitetet e vitit 2018 në departamente të rëndësishme, përfshirë prokurimin, menaxhimin e financave, menaxhimin e automjeteve, çertifikimin e pagesave etj.

Vlerësimi ynë është se raportet e NjAB-së janë cilësore dhe menaxhmentit i kishin ofruar pasqyrë të qartë mbi nivelin e efikasitetit dhe efektivitetit të operimit të kontrolleve të brendshme, si dhe janë dhënë rekomandime konkrete për përmirësim të mëtutjeshëm. Vlen të potencohet se NjAB pos vlerësimit të kontrolleve bazuar në Ligjin për Kontrollin e Financave Publike, ka bërë edhe raportimet tek Ministri dhe MF. Komiteti i auditimit (KA) gjatë vitit 2018 kishte mbajtur dy takime në të cilat kishte diskutuar për zbatimin e rekomandimeve të NjAB. dhe kishte përgatitur një raport për periudhën Janar-Qershor të vitit 2018, me kërkesën që menaxhmenti i ministrisë të zbatoj në tërësi rekomandimet e NjAB.

Çështja A6 - Zbatimi i rekomandimeve të NjAB-së dhe mos mbajtja e takimeve të KA

Gjetja

Sipas Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Zyrtari Kryesor Administrativ, ndër të tjera, duhet të ndërmer veprime për përmirësimin e sistemeve në pajtim me rekomandimet e auditimit të brendshëm. Po ashtu, sipas rregullave për Funksonimin e Komitetit të Auditimit për sektorin publik, kërkohet që takimet e KA të mbahen së paku katër (4) herë në vit.

Ne kemi vërejtur se nga 39 rekomandimet e dhëna nga NjAB, vetëm 17 ishin zbatuar plotësisht, 11 ishin në proces të zbatimit dhe 11 tjera nuk ishin zbatuar. Kjo ishte theksuar edhe në raportin vjetor që NjAB e kishte dërguar në Njësinë Qendrore Harmonizuese tek Ministria e Financave.

Po ashtu, kemi identifikuar se KA gjatë vitit 2018 kishte mbajtur vetëm dy takime të rregullta, dhe jo katër sa është minimumi i përcaktuar sipas rregullave.

Arsyeja e mos zbatimit të rekomandimeve në nivelin e duhur është për shkak se nuk kishte monitorim formal nga ana e menaxhmentit, ndërsa arsyetimi për mos mbajtjen e takimeve të rregullta nga ana e KA ishte se kryesuesi i KA kishte qenë i angazhuar në aktivitetet për transformin e MFSK në Ministri të Mbrojtjes.

Rreziku

Mos adresimi i plotë i rekomandimeve të NjAB-së rrit rrezikun e përsëritjes së gabimeve dhe mangësive të identifikuar në funksionimin e kontrolleve të brendshme. Mungesa e kontributit të komitetit të auditimit për ta shtyrë përpara adresimin e rekomandimeve të NjAB, rritë rrezikun që rekomandimet të mbesin të pazbatuara.

Rekomandimi A6 Ministri duhet të rritë përgjegjësinë në të gjitha nivelet menaxhuese të ministrisë që rekomandimet e dala nga auditimi të trajtohen me kujdesin maksimal. Po ashtu, nga komitetit duhet të kërkohet që të mbajë minimumin e takimeve për t'i trajtuar çështjet e ngritura nga auditimi.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Menaxhmenti i MM-së ka dizajnuar sisteme të mira të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar, përfshirë strukturën organizative dhe linjat e llogaridhënies. Ne kemi marrë siguri nga funksionimi i kontrolleve të brendshme dhe jemi mbështetë në funksionimin e tyre.

Procesi i raportimit të brendshëm në MM funksionon sipas zinxhirit llogaridhënës dhe atij komandues të parashikuar me ligjin dhe strukturën organizative të MM-së dhe FSK-së. Lidhur me këtë, menaxhmenti mban takime të rregullta me të gjitha departamentet dhe njësitë e saj. Temat dhe konkluzionet e takimeve ishin pasqyruar në procesverbalet e rregullta.

MM ka plotësuar kërkesat e MFK-së duke e hartuar matricën e rreziqeve të mundshme, ku janë përfshirë: identifikimi, vlerësimi, trajtimi i rreziqeve, si dhe analizimi dhe raportimi përfundimtar mbi sistemin e menaxhimit vjetor të rreziqeve. Janë përcaktuar edhe llojet, gjasat e ndodhjes së rreziqeve, veprimet që do të ndërmerren nga departamentet përkatëse dhe afatet brenda të cilave do të bëhet monitorimi tyre. Për vitin 2018, monitorimi ishte bërë në baza tre mujore.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 të ka rezultuar në pesë (5) rekomandime. MM kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, tri (3) rekomandime janë zbatuar plotësisht dhe dy (2) ishin zbatuar pjesërisht. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Realizimi i Buxhetit	Ministri duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar me fokus të veçantë në projektet kapitale.	Ministria kishte përmirësuar performancën buxhetore. Në vitin 2018 realizimi i buxhetit për investime kapitale ishte 95%.	Rekomandim i zbatuar.
2	Menaxhimi i personelit	Ministri duhet të kërkojë nga personat përgjegjës që të inicojnë procedurat për plotësimin e këtyre pozitave me stafit të	Përkundër përpjekjeve për adresim,	Rekomandim i mbyllur pjesërisht i

		rregullt, brenda një afati të arsyeshëm kohor.	kjo çështje edhe me tutje mbetet e pazbatuar.	zbatuar.
3	Investimet Kapitale	Ministri duhet të kërkoj nga personat përgjegjës shtim të kontrolleve dhe të fokusit në këtë pjesë të procesit të prokurimit, në mënyrë që të përmbushën kërkesat e rregullave të prokurimit dhe për të evituar vonesat eventuale në realizimin e projekteve të caktuara.	Menaxhmenti kishte ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e rekomandimit	Rekomandim i zbatuar.
4	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Ministri duhet të inicioj një vlerësim të progresit rreth realizimit të planit të veprimit, për të identifikuar barrierat që po pengojnë zbatimin e rekomandimeve dhe të përcaktojë masat e nevojshme për tejkalimin e këtyre barrierave.	Menaxhmenti ishte përpjekur që ti adresoj rekomandimet tona, por edhe më tutje duhet angazhim, në mënyrë që ato të zbatohen plotësisht.	Rekomandimi mbyllur pjesërisht i zbatuar.
5	Qeverisja e Mirë	Ministri duhet të siguroj që lista e rreziqeve, po monitorohet në vazhdimësi, në baza tremujore, për të reduktuar ndikimin në nivele të pranueshme, si dhe të merren veprimet e duhura, në rastet kur janë të nevojshme, për të vendosur nën kontrolle kërcënimet e ekspozuara.	Menaxhmenti bënë monitorimin e rreziqeve në baza tremujore.	Rekomandim i zbatuar
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	Menaxhimi financiar dhe kontrolli	Ministri duhet të siguroj se kontrollet e brendshme në fushën e menaxhimit të të personelit do të forcohen, me qëllim që dosjet të azhurnohen me kohë dhe të përmbajnë informatat komplete për të gjithë të punësuarit e institucionit.		
2	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Ministri duhet të siguroj se Departamentet përkatëse për zbatimin e kontratave, të zbatojnë të gjitha dispozitat lidhur me obligimet e palëve në marrëveshje dhe pa vonesë të ekzekutojnë të gjitha garancionet për sigurinë e ekzekutimit nga ana e OE, duke mos përjashtuar edhe paditë gjyqësore.		
3	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet	Ministri duhet të siguroj se do të zbatohen kontrolle më rigorozë në monitorimin e zbatimit të kontratave, dhe në rast të vonesave në liferimin e mallrave, të aplikohen ndëshkimet e përcaktuara sipas kushteve të parapara me kontratë.		

	komunale	
4	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj se me rastin e hartimit të specifikave teknike për projekte dhe furnizime, departamentet përkatëse paraprakisht bëjnë të gjitha analizat e duhura, përfshirë edhe ato të tregut, në mënyrë që projektet të realizohen brenda afateve optimale dhe me cilësinë e duhur.
5	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri duhet të siguroj që procesi i inventarizimit të kryhet në pajtim me kërkesat që dalin nga udhëzuesi i brendshëm për menaxhimin e pasurive, dhe të bëhet harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistrat e pasurive të organizatës, para përgatitjes së pasqyrave financiare.
6	Sistemi i Auditimit të Brendshëm	Ministri duhet të rritë përgjegjësinë në të gjitha nivelet menaxhuese të ministrisë që rekomandimet e dala nga auditimi të trajtohen me kujdesin maksimal. Po ashtu, nga komitetit duhet të kërkohet që të mbajë minimumin e takimeve për t'i trajtuar çështjet e ngritura nga auditimi.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATUMI I DASHURITESH DATE OF INTEREST		20.05.2019	
Nr. Dreg. Div. Kodim. Div. Udh.	Sht. Klasif. Klasif. Kod. Klasif. Udh.	Nr. Prot. Nr. Prot. No.	Nr. Fletëve Nr. Stranica No. Pages
03	47	757	1



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Mbrojtjes
 Ministarstvo Odbrane Ministry of Defense

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Mbrojtjes, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturën dhe rekomandimin dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimit, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.



Z. Shkelzen Sylaj
 Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes
 Data: 17.maj.2019, Prishtinë,